

VENDIM
Nr. 403, datë 8.5.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
HIMARË-POTAM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Himarë-Potam”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë truell 33 (tridhjetë e tre) m², me vlerë 105 600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, si dhe për objekt me vlerë 562 387 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë, të përballohen nga Autoritetit Rrugor Shqiptar.

5. Vlera totale e shpronësimit, prej 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, zëri “Investime”.

6. Shpronësimi të fillojë më 10.5.2013.

7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja, sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzohet pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoritetit Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarit për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja, sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, pasi të përfundojë procesi i regjistrimit, fakt, i cili do të konfirmohet nga ZVRPP-ja, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzohet nga pronari.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha